



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 35/4 Prot.

Tiranë, më 05.02.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datën 05.02.2020 ditë e premte, ora 10.00, në sallën e mbledhjeve të Prokurorisë së Përgjithshme, u mbajt mbledhja plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Arben Dollapaj
6. Bujar Sheshi
7. Kosta Beluri
8. Sandër Beci
9. Esmeralda Keshi

Nuk janë të pranishëm anëtarët:

1. Vate Staka
2. Besnik Cani

Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

1. Drejtori i Kabinetit

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë z.Gent Ibrahimi, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të



Drejtësisë” i ndryshuar, pasi verifikon pjesëmarrjen e anëtarëve dhe kuorumin, bën hapjen e saj dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i projekt aktit “Për plotësimin e pozicioneve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë përmes procedurës së komandimit të prokurorëve”.
2. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime).

Më pas Kryetari parashtron propozimin për përfshirjen në rend të ditës të dy pikave si më poshtë:

1. Miratimi i projekt aktit për miratimin e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit z. Adnan Xhelili, propozim nga z. Balla.
2. Shpallja e procedurave për komandimin e 6 prokurorëve pranë zyrës së ILD.

Z. Ibrahimimi pyet nëse anëtarët kanë çështje të tjera për t’i përfshirë në rend të ditës.

Nuk ka.

Z. Ibrahimimi hedh në votim propozimin për përfshirjen në rendin e ditës të çështjeve më lart.

Ky propozim miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahimimi vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit “Për plotësimin e pozicioneve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë përmes procedurës së komandimit të prokurorëve”.*

Z. Ibrahimimi i bën me dije Këshillit që prej 1 viti pranë KLP janë komanduar 6 prokurorë, që ndihmojnë Këshillin në përmbushjen e detyrave që parashikon ligji i rivlerësimit, për vlerësimin profesional të prokurorëve, të cilët i nënshtrohen procedurës së vetingut. Afati 1 vjeçar i komandimit, ka qenë një zgjidhje e Këshillit, me qëllim evidentimin e aftësive të tyre profesionale, afat i cili përfundon në datën 22 shkurt. Duke iu referuar procedurave të parashikuara në ligjin 96/2016“ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, për komandimin e tyre pranë institucioneve të ndryshme të drejtësisë siç është KLP, procedurat që rregullohen në nenin 54 të ligjit të sipërcituar, që Këshilli të shpallë të hapur garën për të paktën 2 javë, kohë që i duhet atij për të përgatitur opinione mbi kandidatët që shprehin interesin.



Z. Ibrahim i thekson që, pikërisht kjo emergjencë për afatin, ishte arsyeja e thirrjes së kësaj mbledhjeje si dhe bën një kujtesë Këshillit që pikat që përfshihen në rend të ditës, duhet të miratohen me të paktën 6 vota (kuorumi i nevojshëm).

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Balla shprehet se, 6 prokurorët e komanduar kanë qënë një ndihmesë e madhe për Këshillin. Propozon që, për shkak të numrit të madh të dosjeve dhe për t'u përgjigjur ritmit të kësaj pune voluminoze, të shtohen dhe 2 prokurorë të tjerë. Në këtë mënyrë, Këshilli i vjen akoma më mirë në ndihmë organeve të vetingut dhe nuk bëhet pengesë për to. I propozon Këshillit që:

1. të përsërisë procedurën e komandimit, pa shpallur një garë të re (bazuar në ligjin nr.97/ 2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë"), me qëllim thjeshtësimin e kësaj procedure, për të shkurtuar kohë dhe

2. T'u merret mendimi i këtyre 6 prokurorëve nëse duan të heqin dorë apo të transferohen.

Z. Ibrahim sqaron se, për shkak të hapësirës së kufizuar që ofron organika e Këshillit, nuk është e mundur që të shtohen dhe 2 prokurorë të tjerë. Në lidhje me afatin e periudhës së komandimit për këta prokurorë, u shpreh se nuk është dakord me variantin për një periudhë 1 vjeçare dhe 5 vjeçare (variant që doli nga diskutimet e anëtarëve).

Z. Sheshi i propozon Këshillit afatin 3 vjeçar. I kërkon Këshillit që të ketë parasysh, afatin 3 vjeçar të procedurave të vetingut. Z. Sheshi ashtu si z. Balla, shprehet se, Këshilli mund të mblidhet në çdo moment që ai e vlerëson të arsyeshme për të kërkuar ndërprerjen e këtij afati.

Z. Beluri i propozon Këshillit afatin 2 vjeçar. Arsyeton se, përfundimi i mandatit të komandimit, është një bonus për magjistratin.

Znj Seiti propozon që Këshilli të angazhojë në këto procese edhe punonjës brenda organikës së Këshillit. Mbështet variantin e z. Sheshi që, këta prokurorë të komandohen për një periudhë 3 vjeçare, me arsyetimin që ky afat, do t'i bëjë këta prokurorë më të qëndrueshëm në punën e tyre dhe nuk do t'i çorientojë. Thekson se, është e nevojshme që prokurorët të kenë qëndrueshmëri në karrierën e tyre. Nuk është regres që prokurori në mes të mandatit të tij, kalon në një pozicion tjetër. Komandimi është pëlqimi i magjistratit

Znj Keshi propozon afatin 2 vjeçar të komandimit, për të ruajtur fleksibilitetin e vendimmarrjes së Këshillit dhe për t'u përshtatur nevojave që ka sistemi i prokurorisë për personel. Sjell në

vëmendje, afatin 2 vjet e gjysmë të institucionve të vetingut. Znj. Keshi shprehet se, nuk është favorizuese ndërprerja e komandimit para mandatit pa kërkesën e magjistratit, e penalizon atë. Shprehet se, përfundimi i mandatit, të konsiderohet si një vlerë e shtuar për të.

Z. Bazaj i propozon Këshillit periudhën 2 vjeçare. KLP do të plotësojë me dokumentacionin përkatës i cili përpunohet nga KPK (2 vjet e gjysmë deri sa ta përfundojë afatin) prandaj nuk mendon që, këta magjistratë duhet të jenë deri ditën e fundit të mandatit të tyre.

Z. Ibrahimimi Sqaron se, KPK nuk do të marrë dosje nga Këshilli ditën e fundit, por, duhet t'i marrë dosjet 6 muaj para se të përfundojë aktiviteti i saj.

Z. Balla propozon afatin 3 vjeçar. Shprehet se, me përfundimin e veprimtarisë së KPK do të jetë Këshilli institucioni që do ta zhvillojë këtë proces. Në këto kushte, propozon këtë afat dhe Këshilli mund të mblidhet në çdo moment që ai e shikon të arsyeshme dhe të kërkojë ndërprerjen e afatit. E konsideron si alogjik faktin që, magjistrati të penalizohet nëse ndërpret komandimin para përfundimit të mandatit.

Z. Dollapaj propozon afatin 3 vjeçar, sipas nenit 57 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar. Nëse magjistrati ka nevojë të shkëpusë marrëdhëniet në lidhje me komandimin, mund ta bëjë me kërkesë e tij dhe me miratimin e institucionit përkatës, KLP për rastin konkret. Një magjistrat që është i komanduar kur ka një vend vakant ka përparësi nga kandidatët e tjerë.

Z. Beci është dakord me arsyetimin e Znj. Keshi. Sqaron se është prioritet për magjistratin nëse ai e përfundon mandatin e komandimit.

Z. Ibrahimimi hedh në votim propozimin për afatin 3 vjeçar të komandimit.

Miratohen me 6 vota pro. 3 vota kundër: Z. Bazaj, z. Beluri dhe znj. Keshi.

Z. Ibrahimimi hedh në votim projektvendimin në tërësi.

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahimimi vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për miratimin e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit z. Adnan Xhelili, propozim nga z. Balla.*

Z. Balla relatton në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. Komisioni pasi ka kryer të gjitha verifikimet përkatëse, i propozon Këshillit që të miratojë raportin.

Z. Ibrahimimi pyet nëse ka pyetje dhe komente.



Z. Bazaj u shpreh se, pas njohjes me materialin e sipërcituar, vlerëson punën e Komisionit në interpretim të nenit 149/ç, 179 të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, nenit 71, 96 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, i propozon Këshillit ta miratojë këtë raport.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

➤ *Shpalljen e procedurave për komandimin e 6 magistratëve pranë zyrës së ILD.*

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Ibrahim i bën me dije Këshillit që, ILD i kërkon Këshillit të Lartë të Prokurorisë nëpërmjet një shkresë, që të vlerësojë nisjen e procedurave për komandimin e 6 magistratëve për një periudhë 5 vjeçare. Këshilli nuk e ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë, pasi ILD po propozonte disa amendamente nëpërmjet disa dispozitave kalimtare, në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar. ILD nuk pati sukses në këto përpjekje dhe iu rikthye variantit të mëparshëm, atij të komandimit. Z. Ibrahim kujton që, Këshilli ka hapur procedurat për 1 pozicion pranë kabinetit të ILD.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Znj. Seiti i kujton Këshillit që, bazuar në nenin 55, pika 1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, komandimi konsiderohet si ngritje në detyrë. Shtron dy pyetje lidhur me çështjen:

1. Nëse Këshilli do të referohet procedurës standarde të komandimit apo asaj të ngritjes në detyrë.
2. Nëse do të ishte e nevojshme që Këshilli të kishte një Rregullore për ngritjen në detyrë.

Z. Ibrahim propozon që Këshilli të vazhdojë me procedurën e komandimit, i referohet pikës 3, neni 54 të ligjit nr.96/2016 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar. Neni 53/1, paragrafi 2, i ligjit të sipërcituar.

Znj. Keshi i referohet vendimit të kaluar që Këshilli ka marrë lidhur me nisjen e procedurës për komandimin e një magistrati pranë zyrës së ILD (neni 55 i ligjit të sipërcituar). Znj. Keshi, ngre shqetësimin nëse mund të komandohen prokurorë në pozicione të tjera jo në pozicionin e inspektorit pranë kësaj zyre, vendim që Këshilli e ka marrë dhe vlerësuar si të mundur.



Znj Seiti kujton se, në mbledhjen e kaluar të Këshillit, nuk u diskutua organika e ILD. Sqaron se, lidhur me emërtimin “inspektor”, quhet magjistrati që komandohet në çdo institucion jashtë ILD.

Z. Dollapaj sqaron se, nuk është trajtuar në mënyrë specifike, por nuk ka pengesë, i referohet përcaktimit ligjor “në institucione të tjera”.

Z. Sheshi sqaron se, kërkesa e ILD është për komandimin e 6 magjistratëve pranë zyrës së ILD. Këshilli e ka për detyrë të cilësojë pozicionin “inspektor” apo komandim të magjistratit pranë kësaj zyre. Ngre shqetësimin që, ky numër duhet të jetë më i reduktuar dhe afati kohor 5 vjeçar. Z. Sheshi e argumenton qëndrimin e tij, për shkak të ngarkesës në sistem dhe punës së dubluar të ILD me atë të organeve të vettingut. Propozon, një numër magjistratësh jo më shumë se 4 dhe jo më shumë se një afat 3 vjeçar.

Z. Ibrahim sqaron se, është e drejtë e Këshillit të vendosë për numrin e këtyre magjistratëve.

Z. Ibrahim njofton ardhjen e z. Staka në sallë.

Z. Balla propozon, shtyrjen e vendimmarrjes së Këshillit për këtë çështje deri në pritje të verifikimit të numrit të prokurorëve që do të kalojnë automatikisht nga Prokuroria e Përgjithshme, pranë ILD. I referohet një dispozite kalimtare, nenit 283 të dispozitave kalimtare të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe një dispozite kalimtare, (neni 112) të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”. Propozon që Këshilli t’i kërkojë nëpërmjet një shkrese, Prokurorit të Përgjithshëm, një informacion mbi numrin e prokurorëve ku të arsyetohet që asnjëri prej tyre, nuk i përmbush detyrat e inspektimit. Këshilli të marrë vendimin në mbledhjen e ardhshme.

Z. Beluri sqaron se, asnjë nga inspektorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme, nuk ka shprehur dëshirën për të qënë pjesë e ILD. Ata nuk e kanë të detyrueshme, duhet vullneti i tyre.

Z. Ibrahim sqaron se asnjë nga prokurorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme që janë të ngarkuar me detyrën e inspektimit, nuk realizon detyra të mirëfillta inspektimi, duke patur parasysh organikën e brendshme të saj. Asnjë nga ata nuk ka dhënë pëlqimin që të bëhen pjesë e ILD. Propozon një numër më të reduktuar. në krahasim me atë që ILD kërkon.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente për numrin dhe afatin.

Znj Keshi, z. Dollapaj dhe z. Beluri argumentojnë që, një afat 5 vjeçar është i detyrueshëm.

Z. Ibrahim propozon që Këshilli të hapë procedurat e komandimit për 4 prokurorë për një periudhë 5 vjeçare si inspektor, një kërkesë e përgjithshme. Thekson që, për shkak të emergjencës që ka ILD, Këshilli duhet të marrë një vendim në këtë mbledhje plenare.

Znj Seiti shprehet se, ILD për strukturën, mund ti referohet dhe numrit të prokurorëve që i propozon Këshilli.

SEKRETA

Z. Staka shprehet se 4 prokurorë nuk janë të mjaftueshëm.

Z. Ibrahim hedh në votim marrjen e vendimit në këtë mbledhje, emergjenca prevalon.

Miratohet me 10 vota pro.

Z. Ibrahim hedh në votim për hapjen e procedurave për komandimin e 4 prokurorëve për një afat 3 vjeçar.

Miratohet me 10 vota pro.

Në përfundim, Këshilli në mbledhjen e sotme plenare miratoi vendimin për pikën e rendit të ditës si dhe vendimet për dy pikat të cilat u shtuan në rendin e ditës.

Në përfundim duke mos patur pika të tjera për diskutim Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)



KRYETARI

Gent Ibrahim

Shënim:

(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve) Procesverbalit i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë 24/08/2020 Procesverbalit të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi